



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201700573/5

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e plotë të masës së pensionit të pleqërisë të të moshuarit T.P dhe kthimin e shumës së mbajtuar.*

Drejtuar: **Zj. Daniela HASIMAJ**
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

FIER

Siç jeni në dijëni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i moshuari *T.P*, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e plotë të masës së pensionit të pleqërisë që i takon.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi me mbushjen e moshës për pension pleqërie ka dorëzuar dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Duke qenë se nuk i njohën të gjithë vjetërsinë e punës, ka ndjekur rrugën gjyqësore, e cila ka zgjatur për 3 vjet, deri më datë 09.11.2016. Ka përfituar pension pleqërie, duke marrë edhe diferencat përkatëse. Aktualisht ai e merr këtë pension në Fier.

Nga muaji Mars 2017 nuk e ka marrë të plotë masën e pensionit të pleqërisë, duke i mbajtur 70-80 % nga shuma e pensionit.

Ankuesi pretendon se nga ana e Drejtorisë së Financës i është thënë verbalisht se ai është i detyruar të paguajë për qëndrimin dhe ushqimin e tij për 3 vitet që ka qëndruar në institucion, gjatë së cilës ka zgjatur procesi gjyqësor dhe ai nuk e ka tërhequr shumën e pensionit të caktuar nga ana juaj që nga muaji Mars 2017.

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj ankese, ju jemi drejtuar për të na dhënë shpjegimet e duhura për trajtimin e këtij rasti.

Në përgjigje të kërkesës sonë, ndër të tjera na keni informuar se:

“...Me anë të vendimit nr.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, Tajar Përrenjasit i njihen vitet e punës dhe përfiton pension që nga data 01.08.2014, pra që nga data e mbushjes së moshës së pensionit.

Në bazë të VKM-së nr.898 datë 10.11.2010, të moshuarit që përfitojnë pension duhet të derdhen në buxhetin e shtetit 40% të pensionit dhe 60% të pensionit e merr i moshuari për shpenzimet e tij personale. Në muajin Dhjetor 2016, T.P ka marrë pension për periudhën 01.08.2014 deri më Dhjetor 2016, periudhë të cilën ka jetuar në institucion, duke përfituar shërbimet e institucionit dhe nuk ka bërë asnjë derdhje për detyrimin e 40% as si individ në bankë dhe as pranë institucionit. Për muajt Janar dhe Shkurt 2017, i është mbajtur vetëm masa 40% të pensionit pa i llogaritur detyrimet e prapambetura, me idenë që i moshuari do t'i derdhte vet. Në momentin që T.P refuzoi derdhjen e detyrimeve të prapambetura, u vendos që me urdhërin e Brendshëm nr.58 prot. datë 20.03.2017, të moshuarit përveç 40% të radhës të derdhen çdo muaj edhe 6000 lekë deri në realizimin e shumës së detyrimit të prapambetur, shumë e cila është 171,268 lekë. Që nga jmuaj Mars 2017, T.P refuzon marrjen e masës së ngelur të pensionit, që është 2800 lekë në muaj, pasi nuk është dakort për derdhjen e detyrimit të prapambetur. Kjo shumë është në ruajtje pranë institucionit....”

Në analizë të akteve ligjore, të cilat ju i referoheni, konstatojmë se:

VKM nr.114 datë 31.01.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në Institucionet Rezidenciale Publike të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror”, i ndryshuar, ka përcaktuar grupet, pagesat dhe përfitimet e personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, ku sipas 2 :

“2. Personat, që kanë të ardhura, si pension pleqërie, shtetërorë, kooperative apo pension familjar a invaliditeti, kur vendosen dhe përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale publike, derdhen 40 për qind të pensionit”.

Në asnjë dispozitë të këtij vendimi apo të Rregullores së Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Fier, nuk është përcaktuar kompetenca e Institucionit që Ju drejtoni për mbajtjen e shumave të pensionit si në rastin e të moshuarit T.P.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Dhënien e plotë të masës së pensionit të pleqërisë të të moshuarit T.P dhe kthimin e shumave të mbajtuara.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*", lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI